



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:044164

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06186482

KA.nr.356/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ të paditësit “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” ShA, me seli në bulevardin Bill Klinton nr.5 në Prishtinë, kundër të paditurit Zyrës së Rregullatorit për Energji me seli në rrugën Dervish Rozhaja, nr.12 në Prishtinë, dhe personi i interesuar F.H. nga fshati Raskovë në Obiliq, objekti i kontesti anulimi i aktit administrativ, pas seancës publike të shqyrtimit kryesor të datës 16.09.2024 në të cilën morën pjesë të gjitha palët dhe përfaqësuesit e tyre, më 20 shtator 2024 dha këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadiat e paditësit “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” ShA kundër të paditurit Zyrës së Rregullatorit për Energji, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktit administrativ V_1236_2020 të datës 12.02.2020 të Bordit të së paditurit.

A R S Y E T I M

I. Padiat, kërkesëpadiat dhe pretendimet e palëve

1. Paditësi përmes padisë së datës 15.04.2020 e ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të Paditurit, me kërkesë për anulimin e aktit administrativ V_1236_2020 të datës 12.02.2020 të Bordit të së Paditurit.
2. Ai në padi por edhe gjatë seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes ka pretenduar se, vendimin i goditur është jo i drejtë, kjo për arsye se ai korrigjimin e datës 28.07.2017 e ka vlerësuar në përputhshmëri të plotë me procedurat dhe kodin në fuqi, përkatësisht me nenin 4.11.1 të kodit të matjes, sipas të cilit në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës atëherë duhet të bëhen korrigjimet e nevojshme duke e bërë ri

llogaritjen e energjisë elektrike, përkatësisht përmirësimin e faturimit e që në rastin konkret meqenëse konsumatori ka qenë konsumator shtëpiak, ky korrigjim përfshin periudhën 6 mujore. Në lidhje me këtë ka shtuar se, energjia e konsumatorit në njehsorin elektrik numër 45448420 nuk është regjistruar e tëra, konkretisht sistemi i fazës së tretë T është djegur, për pasoj njehsori elektrik ka regjistruar 33.33% më pak energji elektrike. Sipas tij, i Padituri vendimin e saj e mbështetë në mesataren mujore të shpenzimit të periudha të ndryshme, të cilin ne e kundërshtojmë pasi që nuk do të thotë se në periudha krahasuese mund të vërtetohet shpenzimi i njëjtë. Në këtë drejtim ka argumentuar se, nëse marrim shembull periudhat tetor 2019, nëntor 2019 dhe dhjetor 2019 shpenzimi në këta muaj është i ndryshëm, konkretisht në muajin tetor shpenzimi është 547 kWh, në nëntor shpenzimi është 703 kWh, dhe në dhjetor shpenzimi është 355 kWh, ndërsa marrim për bazë krahasimin e këtyre muajve arrijmë në konstatim se korrigjimi i datës 28.07.2017 është real dhe i drejtë, kjo pasi që është bërë në përputhje me shpenzimet e bëra përkatësisht në pjesën e mos llogaritjes të energjisë elektrike.

3. Paditësi gjithashtu i ka kundërshtuar edhe pretendimet e dhëna si dhe pretendimet në përgjigjen në padi të pranuar sot nga Personi i Interesuar. Paditësi se shtuar se, në rastin konkret ai asnjëherë nuk ka potencuar fajësinë apo pafajësinë e konsumatorit, si shihet edhe nga procesverbalin e qendrës e kalibrimit, Paditësi e ka potencuar se nga ana e jashtme e njehsorit nuk ka dëmtime, mirëpo ka pasur dëmtime në pjesën e brendshme të njehsorit. Gjithashtu ka shtuar se, në qoftë se shohim shpenzimin e Personit të Interesuar, mund të vërehet se në muajt kur është bërë korrigjimi ka dallueshmëri të dukshme me muajt e vitit paraparak dhe atij vijues, përkatësisht nëse marrim për bazë periudhën maj 2017 shpenzimi është 123 kWh, ndërsa nëse në qoftë se e krahasojmë me periudhën maj 2016 shpenzimi është 692 kWh, kurse në muajin maj 2018 është shpenzimi 391 kWh. Sipas tij, në qoftë se marrim rezultatet e secilit muaj shohim se ka një diferencë e cila nuk e vërteton konstatimin e bërë nga e paditura.
4. I padituri në përgjigje e tij në padi dhe gjatë gjithë procedurës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që ta refuzoj atë si të pabazuar. Ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet që vendimi i goditur nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi është analizuar me kujdes ankesa e konsumatorit si dhe të gjitha provat materiale si në shkresat e lëndës, ai ka gjetur se konsumatori ka pasur lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Po ashtu ka shtuar se, në analizimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për periudhën kontestuese në njehsorin e vjetër elektrik dhe në

njehsorin e ri për periudhat të njëjta kohore rezulton që konsumatori nuk ka ndryshim të shpenzimeve, përkatësisht nuk a rritje të shpenzimeve. Sipas tij, sikur të qëndronte pretendimi i Paditësit për mos regjistrim të energjisë elektrike për 33.33% më pak sipas raportit të qendrës së kalibrimit, atëherë kjo rritje e shpenzimit do të reflektohej në njehsorin e ri i cili nuk ka defekt, gjë që në rastin konkret nuk ka ndodhur një gjë e tillë. I Padituri gjithashtu ka deklaruar se, në vendimin e kontestuar i ka paraqitur shpenzimet e konsumatorit për periudhat e njëjta që korrespondon me periudhën që konsumatori është korrigjuar dhe kësaj përsëri nuk është reflektuar rritja prej 33.33%. Përveç kësaj, ai ka shprehur se, Paditësi në padinë e tij i referohet muajve tetor dhe nëntor të vitit 2019 me arsyetimin se shpenzimet për këtë periudhë kohore janë të ndryshme, por këto pretendime si të tilla nuk janë relevante për shkak se si referencë për krahasim merret periudha kohore për të cilën edhe është aplikuar korrigjimi, e që në rastin konkret janë muajt 12.2016 – 05.2017. Për më tepër, sipas të Paditurit duke qenë se shpenzimi i konsumatorit ka mbetur i njëjtë, atëherë ai ka ardhur në përfundim që kjo provë apo raport i qendrës së kalibrimit nuk mund të merret si provë meritore në rastin konkret për shkak që provat tjera vërtetojnë në gjendje tjetër faktike.

5. Personi i interesuar në përgjigjen në padi dhe gjatë seancës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e Paditësit dhe i ka kërkuar gjykatës që jo të refuzohet. Ai ka sqaruar se njëtori fillimisht ka qenë në emër të gjyshes së tij Nefise Halimi, e cila ka ndërruar jetë, ndërsa tani ai është i regjistruar si konsumator. Ka shtuar se ora e tërhequr në vitin 2017 sipas edhe vet punëtorëve të paditësit nuk ka pasur dëmtime të jashtme ose ndërhyrje nga ne. Në lidhje me këtë ka deklaruar se, para nderimit të njehsorit punëtorët e Paditësit i kanë bërë disa testimet të atij njehsorit ashtu që e ka ndërprerë rrymën dhe kanë verifikuar se gjatë periudhës sa ka qenë e ndërprerë rryma brenda shtëpisë nuk ka pasur shpenzim të energjisë.

II. Provat e administruara dhe gjendja faktike e konstatuar

6. Me qëllim të konstatimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i aprovoi të gjitha propozimet e palëve për administrimin e prova. Në këtë drejtim, në seancën për shqyrtimin kryesor u administruan provat si në vijim: vendimi V_1236_2020 i datës 12.02.2020 i të paditurit; vendimi ZRRE/DMK_V_2009_12_19 i datës 16.12.2019 i të paditurit; kundërshtimi i paditësit i datës 30.12.2019; Dokumenti për anulimin e korrigjimit i datës 11.03.2020 i paditësit; procesverbal mbi nderimin dhe heqjen

njehsorit me numër të referencës 0661540 i datës 13.06.2017; procesverbal i kontrollimit detal të njehsorit të energjisë elektrike me shifër NJ.org.02.nr.13477 i datës 25.07.2017 i paditësit; formulari i ankesës së konsumatorit me numër të referencës 137424 i datës 31.08.2017 së bashku me dëshmi për kontestimin e borxhit; rrjedhja e njehsorit të energjisë aktive në emër të personit të interesuar për periudhën kohore gusht 2002 – mars 2020; transaksionet e konsumatorit në emër të personit të interesuar për periudhën kohore 09.10.2002 – 27.03.2020; certifikata e vdekjes me numër serik V 10312997 e datës 30.12.2019 lëshuar nga ZGJC në Obiliq; certifikata e vdekjes me numër serik V 00082946 e datës 11.11.2011 lëshuar në Obiliq, si dhe fatura për konsumatorin në shifër DPR 56321 për muajin korrik 2024 lëshuar nga paditësi.

7. Gjykata pas analizimit të provat të cekura më lartë në kuptim të nenit 8 të LPK-së dhe duke i zbatuar rregullat e të provuarit nga neni 322 i LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së e konstatoi gjendjen faktike të përshkruar më poshtë.
8. Paditësi përmes punëtorëve të autorizuar për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse te Personi i Interesuar dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik me nr. 45448420, me gjendje TL=11239 kWh dhe TU=22949kWh duke vendosur njehsorin elektrik të ri me nr. 67786868 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Këtë fakt gjykata e vetëtoi përmes procesverbalit nr. 0661540 të datës 13.06.2017.
9. Lidhur me këtë gjetje, më datë 25.07.2017 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit te Paditësi kanë bërë shqyrtimin e njehsorit elektrik me nr. 45448420 me gjendje TL=11239 kWh dhe TU=22949kWh duke konstatuar se njehsori elektrik pllombat i ka në rregull, nga ana e jashtme nuk ka dëmtime, në brendi të njehsorit sistemi i fazës së dytë është i djegur dhe si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrike për 33.33% më pak. Këtë fakt gjykata e vetëtoi përmes Nj.Org.02 nr. 13477 të datës 26.07.2017.
10. Pas kësaj, Departamenti i Faturimit i Paditësit e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues prej 59.93euro. Këtë fakt gjykata e vërtetoi përmes kundërshtimit të Paditësit ndaj vendimit të shkallës së parë të së Paditurit.
11. Ndaj kësaj Personi i Interesuar si konsumator kishte paraqitur ankesë, në lidhje me faturën e korrigjimit plotësues, ndërsa më 23.09.2017 Departamenti për Konsumator i Paditësit e kishte refuzuar ankesën e konsumatorit. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes kundërshtimit të Paditësit kundër vendimit të shkallës së parë të së Paditurit.

12. Personi i Interesuar i pakënaqur me refuzimin nga Paditësit, më 20.10.2017 i është drejtuar Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit të së Paditurit me ankesë, i cili përmes vendimit ZRRE/DMK_ V_2009_12_19 të datës 16.12.2019, duke e aprovuar ankesën e Personit të Interesuar si konsumator, e ka obliguar Paditësin që konsumatorin ta shkarkoj nga korigjimi shtesë në vlerë financiare prej 59.93€, me arsyetim se nuk ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike mes njehsorëve elektrike. Këto fakte gjykata i vërtetoi përmes vendimit të sapo cekur.
13. Ndaj vendimit të cekur më lartë, Paditësi kishte ushtuar ankesën, të cilën përfundimisht i Padituri përmes Bordit të tij më 12.02.2020 e kishte nxjerrë vendimin V_1236_2020, me të cilin e kishte refuzuar në tërësi ankesën e Paditësit dhe e kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë. I Padituri vendimin e tij e kishte arsyetuar mes tjerash, se bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik dhe njehsorit të ri elektrik, konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore, ndërsa sipas analizës së të dy njehsorëve, për periudha të njëjta kohore nuk është konstatuar se ka ndryshim të shpenzimeve, rrjedhimisht njëtori ka bërë majte të rregullt.
14. Gjykata gjithashtu konstatoi se konsumatorja e dikurshme N.H. ka ndërruar jetë, ndërsa si bartës i njëtorit është i regjistruar personi i interesuar F.O.H., si nip i të ndjerës. Për pasoj, gjykata vlerëson se Personi i Interesuar ka legjitimitet për të qenë palë në këtë procedurë.
15. Provat tjera të administruara nga gjykata nuk provuar ndonjë fakt tjerët relevant lidhur me këtë çështje, prandaj gjykata vendosi të mos lëshohet në elaborimin e hollësishëm të tyre.

III. Vlerësimi meritor i rastit

16. Gjykata në rend të parë e shqyrtoi se a ka pasur kompetencë i Padituri për ta dhënë vendimin e goditur dhe gjeti se në bazë të nenit 17 para. 1 nënpara. 1.1 të Ligjit 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesa nga konsumatorët kundër të licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara, ndërsa në bazë të nenit 17 të Rregullores për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, Bordi i ZRRE-së është përgjegjës për të vendosur për ankesat ose kontestet që paraqiten pranë tij. Prandaj

gjykata erdhi në përfundim se i Padituri ka qenë kompetent për ta dhënë aktin administrativ të goditur. Në këtë drejtim, gjykata vëren se nga Paditësi nuk ishte ngritur asnjë pretendim i kësaj natyre.

17. Përveç kësaj, gjykata vëren se i Padituri ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm për të gjitha çështjet relevante të rastit, si dhe për të gjitha pretendimet e Paditësit, që i ka paraqitur në kundërshtimin e tij. Kështu, nga arsyetimi i aktit administrativ të goditur janë dhënë arsye për çdo pretendim ankimor të Paditësit, duke elaboruar të gjeturat e të Paditurit, si organ kompetent për të vendosur lidhur me kundërshtimin e Paditësit. Gjykata vëren se Paditësi nuk kishte paraqitur pretendim lidhur me arsyetimin e vendimit të goditur.
18. Gjykata gjithashtu konstaton se i Padituri e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, si dhe nga faktet e vërtetuara ka ardhur në përfundimin e drejtë të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, gjykata e përkrah qëndrimin e të Paditurit si organ administrativ, se Paditësi në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se konsumatori e ka shpenzuar energjinë elektrike të faturuar përmes korrigjimit.
19. Gjykata vëren se Paditësi kërkesën e tij për anulimin e vendimit të goditur e mbështet në konstatimet e ekipit të tij në qendrën e tij të kalibrimit, të konstatuar në procesverbalin Procesverbal NJ.org.02.nr.13477 i datës 26.07.2017. Për këtë gjykatë, gjetjet e ekipit të Paditësit si në procesverbalin e sapo cekur, si të vetme, juridikisht nuk janë të besueshme. Në rend të parë, gjykata sqaron se procesverbali i tillë nuk i plotësohet kushtet ligjore nga neni 329 i LPK-së për tu trajtuar si dokument publik, rrjedhimisht saktësia e tij nuk prezumohet sipas të njëjtit nen. Në anën tjetër, kontrollimi i njësorit është kryer nga ekipi i vetë Paditësit, gjë që e karakterizon atë me mungesë të objektivitetit në kryerjen e testeve dhe paraqitjen e gjetjeve. Mungesa e objektivitetit rritet sidomos duke marrë parasysh faktin se konsumatori, por edhe i Padituri, nuk e kanë pasur e as tani nuk e kanë asnjë mundësi faktike ose juridike që ta provojnë se gjetjet e ekipit të Paditësit janë të pasakta. Prandaj, për këtë gjykatë, fakti se gjetjet e Paditësit për energjinë elektrike të shpenzuar nga konsumatori bazohet vetën në testimet e kryera nga ekipit të tij, ndërsa konsumatori nuk e ka pasur asnjë mundësi ta provojë të kundërtën e konstatimeve të ekipit të Paditës, provën e tillë e bënë juridikisht të pabesueshme për t'i provuar pretendimet e Paditësit.

20. Po të pranohej saktësia e konstatimeve të ekipit të Padiësis, pa u mbështetur në prova tjera, ose pa i dhënë mundësin konsumatorit ose subjekteve tjera që ushtrojnë kontrolle mbi veprimtarin e Padiësis, që ta provojnë të kundërtën e gjetjeve të ekipit të Padiësis, atëherë procesverbal i kontrollimit detal të njësorit të energjisë elektrike në Departamentin e AMR& Kalibrim në të cilën paraqiten gjetjet e Padiësis lidhur me gjendjen e njësorit dhe regjistrimit e rij do të kishte fuqi provues absolute, ndërsa ankesa ndaj korigjimeve të shpenzimeve të energjisë elektrike të paraqitura nga Padiësi dhe mjetet tjera juridike në dispozicion nuk do të ishin fare efektive, pasi parregullsitë në njëSORIN elektrik ose në regjistrimin e shpenzimeve do të konstatoheshin me vet faktin se vet Padiësi ka konstatuar ashtu. Një situatë e tillë, konsumatori do të ishte në pozitë të disfavorshme dhe juridikisht të pafuqishme karshi Padiësis.
21. Gjykata e sheh të rëndësishme të sqaroj se, me vlerësimin e tillë të procesverbalit të kontrollimit detal të njësorit të energjisë elektrike në Departamentin e AMR& Kalibrim të vetë Padiësis, në të cilën paraqiten konstatimet e ekipit të Padiësis për gjendjen e njëSORIN elektrik, nuk e shpallë të pavlefshëm procesverbalin e tillë, por thjeshtë e trajton atë si të pamjaftueshëm që si i vetëm dhe pa mbështetje të provave tjera të provoj pretendimin se gjetjet e tij janë të sakta.
22. Në anën tjetër, në mungesë të të dhënave tjera lidhur me shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit për periudhën e kontestuar, përdorimi i metodës krahasuese të shpenzimi të konsumatorit për këtë gjykatë paraqet provë të pranueshme për të provuar se gjetjet e Padiësis për korigjimin e shpenzimeve të konsumatorit ishin të pasakta, për derisa nuk paraqiten prova tjera, nga të cilat në mënyrë objektive rrjedh gjendja reale e shpenzimeve të konsumatorit.
23. Për arsyet e cekura më lartë gjykata përfundimisht vlerëson se vendimi i goditur është nxjerrë duke i respektuar dispozitat e procedurës administrative, organi administrativ e ka konstatuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejtë dispozitat materiale administrative, si dhe i Padiuri ka qenë organ kompetent për nxjerrjen e vendimit të tillë, rrjedhimisht nuk ka asnjë arsye ligjore që ai të anulohet, për pasoj e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e Padiësis.
24. Prandaj gjykata përfundimisht vlerëson se kërkesëpadia e padiësis është e pabazuar, rrjedhimisht duhet të refuzohet. Për këto arsye, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12

lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Komerciale e Kosovës
Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative
KA.nr.356/22

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktgjykimit mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.